

Data 17.09.2026

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – SHËRBIME
(PROCEDURË E HAPUR, MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR)
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “MIRËMBAJTJA E SISTEMEVE TË LAJMËRIMIT TË SITUATËS SË EMERGJENCIVE NË PUBLIK (FIERZË, KOMAN, VAU I DEJËS PËR 3 VJET PËR SISTEMET EKZISTUESE)”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): SHËRBIME TË TJERA - 98390000-3.

VLERA E FONDIT LIMIT: 90,000,000 (NËNTËDHJETË MILION) LEKË PA TVSH OSE 981,354 (NËNTËQIND E TETËDHJETË E NJË MIJË E TREQIND E PESËDHJETË E KATËR) EURO.

KURSI ZYRTAR I KËMBIMIT SIPAS BANKËS SË SHQIPËRISË NË DATË 17.09.2026 ËSHTË 91.71 LEKË/EURO.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, KESH sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar citohet: *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*, Neni 82, i LPP i ndryshuar “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është hartuar në mbështetje të nenit 77, pika 1, shkronja “a”, dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 41, pika 4, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlogaritur të fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika a e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që Operatori Ekonomik ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë operatori ekonomik ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlogaritur të fondit limit. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë

autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar.

Vlera e xhiros së përcaktuar dhe të kërkuar nga autoriteti kontraktor kërkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorit ekonomik si dhe për të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit:

Ligjin Nr. 29/2023 Për tatimin mbi të ardhurat (Ndryshuar me aktin normativ Nr.2, datë 7.6.2023; aktin normativ Nr.7, datë 14.12.2023, vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.52, datë 27.6.2024; aktin normativ Nr.4, datë 27.11.2024, Ligjin Nr. 9/2025, datë 30.1.2025; Nr.81/2025, datë 11.12.2025) (i përditësuar).

Vendim Nr.211, datë 9.4.2025 Për disa ndryshime në vendimin Nr.922, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Udhëzim Nr.24, datë 6.11.2025 për disa shtesa dhe një ndryshim në udhëzimin e përgjithshëm Nr.26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit, brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Kjo përqindje është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 41 pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, ku citohet se:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e shërbimeve të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë ka si qëllim sigurimin e faktit që operatori ekonomik ka përvojë dhe aftësi të mjaftueshme për të realizuar kontrata të ngjashme me atë që po kërkohet. Në këtë mënyrë, AK synon të sigurojë se operatori ka kapacitetin për të përmbushur kërkesat dhe për të ofruar shërbime apo produkte që janë të ngjashme në natyrë dhe në vlerë me ato që janë të parashikuara në kontratë. Përvojat e mëparshme në kryerjen e shërbimeve të ngjashme janë një indikator i rëndësishëm i aftësisë së operatorëve për të menaxhuar projekte dhe për të përmbushur afatet dhe standardet e kërkuara. Nëse një operator ka një histori të suksesshme të realizimit të kontratave të ngjashme, kjo ul mundësinë e dështimit të kontratës së re, duke e bërë procesin më të sigurt dhe më të besueshëm për palën kontraktuese.

Operatorët ekonomikë që kanë përvojë të mëparshme në fushat e ngjashme janë më të besueshëm në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve që kërkohen. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për projekte që kërkojnë cilësi të lartë dhe përputhje me standardet. Përvoja e mëparshme tregon se operatori ka kapacitetin për të siguruar cilësinë dhe të përmbushë kërkesat kontraktuale.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, të cilat duhet të përkojnë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ✚ **SSH/EN/ISO 9001** - “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- ✚ **SSH/EN/ISO 45001** - “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e certifikatave të mësipërme është hartuar në mbështetje të nenit 79 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 44 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin teknik të kontratës, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë sisteme të certifikuara të menaxhimit, të cilat dëshmojnë aftësinë e tyre për të realizuar shërbimin në përputhje me standardet ndërkombëtare të cilësisë, dhe sigurisë dhe shëndetit në punë të punonjësve gjatë realizimit të kontratës

Konkretisht:

✚ **SSH/EN/ISO 9001** - “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruara dhe proceset e mirëmbajtjes janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

✚ **SSH/EN/ISO 45001** - “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” Ky standard kërkohet duke marrë në konsideratë natyrën e shërbimeve objekt prokurimi, të cilat përfshijnë ndërhyrje periodike dhe korrektive në stacionet e alarmit, qendrat e kontrollit, pajisjet elektrike dhe elektronike, strukturat mbajtëse, sistemet e furnizimit me energji dhe pajisjet e komunikimit. Zbatimi i këtij standardi synon të garantojë menaxhimin e rreziqeve për shëndetin dhe sigurinë e personelit gjatë kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, minimalisht për periudhën Qershor 2026 - Gusht 2026, punonjësit si më poshtë:

- ✚ 1 (një) inxhinier Elektrik;
- ✚ 1 (një) inxhinier Elektronik;
- ✚ 1 (një) inxhinier Mekanik;

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

+ Kontratë pune të vlefshme.

+ Diplomat e inxhinierëve;

+ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Qershor 2026 - Gusht 2026.

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

Konkretisht: Kërkesa teknike që Operatori Ekonomik të ketë në stafin e tij 1 (një) inxhinier elektrik, 1 (një) inxhinier elektronik dhe 1 (një) inxhinier mekanik është në përputhje dhe në përputhje me objektin e kontratës, duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin teknik të shërbimeve që parashikohen të realizohen.

Inxhinieri Elektrik kërkohet për shkak të ndërhyrjeve dhe kontrolleve që parashikohen në sistemet e furnizimit me energji elektrike të stacioneve të alarmit, bateritë, karikuesit, inverterët, konverterët DC/DC, panelet fotovoltaike, kabllimet dhe komponentët e tjerë elektrikë të sistemit.

Inxhinieri Elektronik kërkohet për shkak të natyrës së sistemit ekzistues, i cili përfshin pajisje elektronike kontrolli, RTU, module komunikimi GSM, radio, komunikim IP/Ethernet, fibër optike dhe shërbim satelitor, si dhe konfigurimin, diagnostikimin dhe mirëmbajtjen e komunikimit ndërmjet stacioneve të alarmit dhe qendrave të kontrollit.

Inxhinieri Mekanik kërkohet për kontrollin dhe vlerësimin e gjendjes fizike të strukturave mbajtëse të sirenavë, shtyllave/konstruksioneve metalike, tiranteve, bazamenteve dhe elementeve të tjerë mekanikë të stacioneve, si dhe për problematikat që lidhen me dëmtime, deformime apo degradim të këtyre strukturave.

Për sa më sipër, disponueshmëria e këtyre profileve inxhinierike vlerësohet e nevojshme për realizimin efikas të shërbimeve, respektimin e afateve të ndërhyrjes dhe garantimin e gatishmërisë operacionale të sistemit të alarmit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për mallrat dhe shërbimet objekt prokurimi.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj).

Argumentimi:

Ky kriter është hartuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e autorizimit nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën dhe specifikat teknike të objektit të prokurimit,

Duke qenë se gjatë zbatimit të kontratës parashikohen shërbime mirëmbajtjeje periodike dhe korrektive, diagnostikim dhe riparim të defekteve, konfigurim të pajisjeve dhe software-it, si dhe furnizim dhe zëvendësim të pjesëve rezervë, është e nevojshme të garantohet që Operatori Ekonomik të ketë mbështetjen e nevojshme teknike. Kjo kërkesë është në përpjesëtim me natyrën dhe objektin e kontratës dhe synon të minimizojë rrezikun e përdorimit të pjesëve të papërshtatshme ose të papajtueshme dhe të ndërhyrjeve teknike që mund të cenojnë funksionimin normal të sistemit ekzistues.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i punës (sipas procesverbalit pjesë integrale e kësaj procedure) ku në të citohet se:

Specifikimet teknike janë hartuar duke iu referuar konfigurimit dhe karakteristikave teknike të sistemeve ekzistuese të alarmit, të instaluara në tre hidrocentralet e Kaskadës së Drinit, dhe zonat përreth me qëllim garantimin e funksionimit të tyre të pandërprerë, mirëmbajtjen sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe ruajtjen e parametrave të projektimit.

Hartimi i specifikimeve teknike është bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi, konkretisht:

✚ Ligjin Nr. 8756, datë 26.03.2001, “Për emergjencat civile”, në zbatim të të cilit janë hartuar planet e gatishmërisë për situatat emergjente, skemat organizative të veprimit për skenarët e mundshëm të emergjencave, si dhe hartat e përmbytyjeve për rastet e menaxhimit të prurjeve të mëdha dhe të dëmtimit të mundshëm të digave;

✚ Ligjin Nr.8681, datë 02.11.2000, **“Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”**, i ndryshuar;

✚ Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 147, datë 18.03.2004, **“Për miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave”**.

Këto akte ligjore dhe nënligjore përcaktojnë qartë detyrimin e KESH sh.a, për monitorimin e vazhdueshëm të sigurisë së digave dhe njoftimin në kohë të popullatës në rastet e situatave emergjente që mund të krijohen si pasojë e prurjeve ekstreme, operimit të veprave shkarkuese apo problematikave të tjera që mund të cenojnë sigurinë e digave të Kaskadës së lumit Drin.

Për sa më sipër, objekti i specifikimeve teknike përfshin të gjitha furnizimet, shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese dhe korrigjuese, testimet periodike, konfigurimet, përditësimet e nevojshme të pajisjeve hardware dhe software, si dhe çdo ndërhyrje tjetër të domosdoshme për garantimin e funksionimit të vazhdueshëm dhe gatishmërisë së sistemeve të lajmërimit të emergjencës në çdo kohë. Kjo është thelbësore për të siguruar një reagim të shpejtë dhe efektiv në rastet e emergjencave civile, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e sigurisë në fuqi.

Njësia e Prokurimit